



PROCESVERBAL
I mbajtur PËR TAKIMIN E DYTË PUBLIK
ME QYTETARËT E KOMUNËS SË DEÇANIT

Takimi publik është mbajtur me dt. 30 Dhjetor 2025(e Martë) në ora 10:00

Vendi : Salla e Kuvendit në objektin e Komunës.

Në takim kanë marrë pjesë gjithsejt 32 pjesëmarrës (24 burra dhe 8 gra), Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, drejtor të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit dhe qytetarë të komunës së Deçanit.

Kryesues:z.Hajdar Sutaj.

Kryesuesi e ka hapë takimin e dytë publik me qytetar me përshëndetje për të pranishmit, pastaj ka shtuar se këtu sot qytetar të nderuar do të debatojmë për çështjet që ju preokupojnë juve si qytetarë, për ofrimin e shërbimeve cilësore komunale dhe për çështjet lidhur me realizimin e synimeve programore të komunës së Deçanit, gjatë vitit 2025, në vazhdim fjalën ia ka dhënë Kryetarit të Komunës, Z.Bashkim Ramosaj.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve ka prezantuar në pikë të shkurta punën e Ekzekutivit gjatë vitit 2025.

Elton Kadrijaj nga fshati Drenoc, i diplomuar në Infermieri, ka paraqitë kërkesë për mbajtjen e praktikës profesionale në QKMF dhe pse nuk na lejohet neve një gjë e tillë ka thënë ai, sepse mua më është dashur që ta mbaj në kryeqytet praktikën, pastaj ka shtruar pyetjen a ka kapacitet QKMF me i mbajte 4 praktikantë dhe pse nuk lejohet në Deçan mbajtja e praktikës. Çështja e dytë pse po mungojnë barnat nga lista esenciale në QKMF.

Kryetari- përgjigjet se me këto kërkesa e preke thelbin e çështjes. Në Kosovë Ligji i përcakton kriteret për mbajtjen e praktikës që organizohet në QKMF dhe sipas ligjit kjo gjë nuk na lejohet. Barnat te lista esenciale, ne e bëjmë kërkesën por Ministria e ka në kompetencë me na furnizu. Elton Kadrijaj- tre mujorshi i parë i praktikës mbahet në nivelin parësor shëndetësor dhe pse mu nuk më sigurohet një vend si student i kësaj komune.

Kryetari- sqaron se nëse je i profilin të mjekësisë familjare atëherë të ipet licenca.

Kryetari në vazhdim ka sqaruar se ne si Komunë e Deçanit nuk kemi lënë mjek të diplomuar që e ka marrë një licencë që nuk ju ka dhënë mundësia me punua në Deçan dhe ate 6 deri 12 muaj me pagesë.

Kryesuesi meqenëse nuk ka të interesuar tjetër për diskutim, i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

